



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Komuna e Pejës-

Zyra e Kryetarit

I.Numër: 060-01-124701

Pejë, datë: 27 Dhjetor 2022 ora 16.00

PROCESVERBAL

Nga takimi Publik i Kryetarit të Komunës me Qytetarë

Takimi u mbajt në sallën e kuvendit të komunës

Ne takim morën pjesë kryetari Gazmend Muhaxheri, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, nënkryetari Fatmir Asllani, drejtorët e drejtorive, anëtarët e kuvendit, përfaqësues të Bashkesive Lokale dhe qytetarë të komunës së Pejës.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku potencioi që është një diskutim publik që është obligim ligjor i kryetarit të Komunës që ti mbaj dy takime publike brenda vitit me qytetarë, ky takim shërben si njoftim rreth punëve të komunës dhe keni mundësin të jepni sugjerime dhe të parashtroni kërkesat dhe ankesat e juaja.

z.Gazmend Muhaxheri: është një raport për punën e 6 mujorit mirëpo na po e trajtojmë si raport vjetor të punës së Komunës. Po fillojm me drejtori të administratës e cila i ka 8. sektorë, komuna e Pejës i ka pas 127900 lënd prej cilave 73400 lënd apo nëse e kthejmë në përqindje është dikun 57% që i ka kry drejtorja e administratës ,pra në momentin që po raportoj numrin i lëndëve në shqyrtim është 0. pra janë përfundur të gjitha me sukses. Ndërsa sa i përket të hyrave që janë realizu në këtë drejtori përfshir taksat janë diku 148000. Euro, ndersa punët tjera janë administrative që nuk janë shumë në interes të publikut .

Drejtoria për Arsim ka pas sfida të mëdhaja duke nisur nga fillimi i vitit shkollor me grevat që kanë qenë në arsim, ka pas renovimi, investime të ndryshme, ne qershor është kryer procedura e furnizimit me dru, pra të gjitha shkollat janë furnizu me lëndë djegese, është renovu shkolla “Rilindja” në Lutogllav dhe jon bler paisjet sportive për volejball dhe hendboll për me mujt me realizu gara ndërkombëtare, këto janë blerë prej drejtorisë së arsimit, rinovimi i shkollës “Migjeni” Gllogjan, “Smajl Hajdari” Peje, “Zef Serembe” Gillaviqic, Shkolla e Mjeksis, “Vaso Pash Shkodrani” dhe aneksi i shkollës në Trestenik. Po ashtu kemi pas edhe një donacion prej Iom-it për shkollën “Dardania 3” ku janë paisur me kabinete, është në përfundim e sipër shkolla “Vaso Pash Shkodrani” do të jetë një shkoll model ku besojn që deri në muajin Maj do të perfundohe, është nisë 2016 diku 7 vjet po i merr nje shkoll , po ashtu jemi tu e ndërto me buxhet vetanak shkollën në Poqest ku deri në fund Majit përfundohet edhe pllaka e katit te dytë. Salla në fshatit Loxhë është që 5 vite e pa përfundume, e kemi tenderu 3 herë po nuk është përfundu. Në Zahaq e kemi ndërpre kontraten me operatorin sepse nuk ka dasht me punua, ka qenë në bashkepunim si projek me MKRS-en por vitin e ardhsem do ta tenderojmë me buxhet vetanak të Komunës.

Drejtoria e Bujqësisë ka me e ndërto një pendë ne fshatin Kotradiq, por që i bjen me i ujit tokat e fshatit Vranoc, tani është lidh kontrata sepse ka pas ankesa në Oshp-ë e cila nuk ka qenë shumë funksionale dhe janë zgjatë procedurat. Kemi pas 12 procedura këtë vit, 8. janë kry ndërsa 4 mbesin për viti tjetër, është kry edhe procedura e furnizimit me multikultivator mirëpo ka mbet që vitin tjetër ka mbet me u bo shpërndarja e tyre te fermerët. Po ashtu është hera e par që e kemi gjet një kompani profesionale që ju ndihmon fermereve me apliku në Ministrin e Bujqësisë që e ka rrit ne mase te madhe numrin e përfituesve nga Komuna e Pejës e vlera kap dikun 380000 mijë euro .

Drejtoria për çështje pronësore juridike ka vazhdu punën e tyre, kemi realizu disa shpronësime-kembime nesër e kemi proceduren e fundit me këtë furren “Mallaku” që është në qendër me ja ndërru pozitën prej anës se djatht me zhvendos ne anën e majt të Korzës dhe këto dyqanet që jane fund ëmbëltorja dhe ato tjerat fund korzes me u shty për 3 metra dhe me kriju shëtitoren prej urës që është te Nëna Terez e deri të Ura e “Zallit” me mujt me qarkullu qytetarët për me mujt me permbyll 1 vit të jashtëzakonshem sa i përket këtyre punëve. Në lagjen Puhovci kanë mbet edhe 3 shtëpi për me u përfundu shëtitorja kanë mbet edhe 3 familje Muriqi, Qërkint dhe prap familja Belegu por planifikojm që ka fundi i vitit te ardhëshem me u realizu kjo komplet.

Drejtoria për Klultur, Rini dhe Sport ka qenë shumë aktive këtë vit përpos numrit të madh të trofve që i kemi realizu, besoj që nesër ose pasnesër e përmbyllim me sukses edhe një shfaqje që e kemi në Galerinë e Arteve, hapjen e ekspozitës dhe ceremoninë e shpalljes së sportistëve të vitit. Është ndërta një fushe e futbollit në Brestovik në bashkëpunim edhe me federatën e futbollit ka mbetur federata me ndërta edhe pjesën e zhveshtorëve dhe hapësirën për refer, ndërsa fushën që e kemi në Raushiq me MKRS-en ka mbetur totalisht jo aktive këtë vit, sepse dikur edhe 300000 mij euro që është dasht me i nda ministria ato nuk janë realizu dhe tash ose duhet me u ndërpre kontrata ose me shikë qysh mundet me i kry vitin ardhshëm.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpetim ka pas mjaft sfida sidomos në 6. mujin e dytë për shkak të vërshimeve që i kemi pas ka intervencu se paki 3. herë për me stabiliziu gjendjen. Po ashtu është përgatit edhe raporti i vlerësimit të dëmëve, në seancë e nesërme e kemi në kuvend për votim dhe shpresoj që qeveria do ta marr parasysht sepse është njëri prej raporteve me të mira në krejt Kosovë.

Drejtoria për Mirëqenje sociale shpresoj që në 3. mujin vitit të ardhëm me kalu në objekt të ri, është edhe shtëpia emergjente për nënat vetushqyse është përfudnu kati i dytë, shpresoj që me u kry edhe i treti dhe me u përfudnu në tërësi janë 12 gazonjera që do të shërbejn për femij dhe nënat që janë në nevoj. Kjo drejtori ka kry punë shumë të mira dhe ju ka dalur në ndihmë kategorive sociale.

Drejtoria për Inspektorat ka pasur shumë angazhime, janë 654 raste tek të cilat ka asistiu dhe janë angazhu maksimalisht. Ndërtimet ilegale janë të ndalume edhe pse kjo drejtori fatkeqësisht ka munges të inspektorve të ndërtimit ndërsa inspektoriat sanitari ka kalu në nivel qendror.

Drejtoria për Punë komunale ka qenë shumë aktive në realizimin e projekteve mirëpo edhe në shpenzimin e buxhetit. Kemi pas në plan ndërtimin e Rrugës "Freskia" në Zagerme, është përfudnu kanalizimii në qytet në disa rrugë, kemi ndërta uren rreth 70 mij euro, zatra, Kapeshnic, Tabje, Jabllanic e Madhe, kemi bërë rrethoja të varrezave në Doberdol, Vragoc e disa fshatra të tjera po ashtu edhe të varrezat katolike këtu në qytet e kemi bërë rrethim e tyre. Është bërë ndërtimi i shtatorëve të grupit të gjeneralve: Skender Ceku, Xhemajl Fetahaj, Agim Qelaj dhe "Bekim Berisha" dhe shpresoj që në fillim të vitit të ardhshëm do të behët inagurimi i këtyr shtatoreve. Sa i përket rrugëve të Rugovës janë kry procedurat e tenderim, ndërsa ata që i kanë pas rrugët e vjetra veq 2 prej tyre i kanë përfudnu rruga "Magra" dhe Shkrel është përfudnu 2700. metra dhe rruga Bogë- Shkrel 600 metra dhe sia rrugica në fshatin Bogë. Ndërsa operatoret

tjër ose nuk kanë punu hiq ose shumë pak me arsytimin e rritjes së çmimëve. Kemi pas 11. procedura të tenderave prej 3500. mij deri 450. mij 3. operator nuk i kanë kry obligimet që i kanë pas ndërsa tjerët i kanë kry obligimet e veta. Me projektin “Demos” është punu shumë këto ditë edhe me drejtorin e financave që me mujt me u perfundu këto projekte qe kanë qenë prej 746 mijë euro qe i kemi pas prej grandit të performancës ne i kemi shpenzuar 700 mijë pra vetëm 40 mijë kthehen mbrapa si të pa shpenzuara, është tu punu te pjesa e “te sharrë” është vendos ura dhe janë tu kry disa punime tjera. Është ndërtu trotuari ne rrugen “Mulla Zeke Berdyna” në Vitomericë neve na mbet me i vendos trupat ndriques po ashtu edhe trotuari ne rrugën kryesore është gati me përfundu edhe ne Bllagaj poshtu. Kryetari potencio që është vazhdu edhe vendosja e ndriçimit ne zonën e qytetit dhe fshatrave dhe hapsirave afër shkollave, janë 11 projekte që janë perfundu me sukses.

Drejtoria e shendetesis, e kemi leshu në përdorim ambulanten moderne në fshatin Kryshec, është përfundu edhe ambulanta në Vitmoreic, mirëpo meqense janë edhe disa punë me u kry ajo do të lëshohet në përdorim në fillim të vitit të ardhshem, poashtu janë tu u kry punët në ambulanten në Kragaq ndërtimi i vrazhdë ndërsa punët finale kryhen vitin tjetër. Është rinovu komplet kati i dytë i poliklinikës stomatologjike, po ashtu është punu depoja kryesore e të gjitha ambulantave. Jnë bërë edhe furnizimet e nevojshme me materiale shpenzuse për të gjitha ambulantat.

Drejtoria për urbanizem si puna më e e rëndësishme ka qene hartat zonale ku jemi në përfundim te tyre, javën e dyt të janarit i dërgojmë në ministri dhe pas shqyrtimit të ë ligjëmeris i miratojmë në Kuvend. Procesi i legalizimit është zgjat dhe 2 vite, është përfundu kanali atmosferik ne lagjen “7 shtatori”, rregullimi i kanalit në lagjen “Zatra-Karragaq”, ndërtimi i kanalit atmosferik në “Fidanishte”. Mbjellja e drunjeve është në përfundim, poashtu kryetari tregoj edhe për disa projekte tjera që kanë filluar por për shkak të kushteve atmosferike nuk ka mujt me u punu shumë.

Drejtoria për zhvillim ekonomik, i ka përfundu të gjitha obligimet e veta, po ashtu e ka shpenzuar buxhetin komplet qe e ka pas. Prokurimi ka përfundu me sukses punët e veta ka kry 90. procedura të prokurimit kemi qenë komuna rekord në shpalljen e konkurseve edhe në shpenzim të buxhetit. Pavaresisht sfidave të rritjes së çmimeve dhe mos aplikimi të rritjes së premtuar prej 20 % nga ana e qeveris ne kemi arrtur me shpenzu 78% të buxhetit dhe kemi mbetur në garen e grandit të përfomances e cila zhvillohet ndermjet komunave. Në shpresoj që në vitin 2024 jemi pretendent kryesor me fitu nëse jo të paret do të jemi ne mesin e më të mirëve.

Te pjesa e të hyrave vetanake na e kemi realizu planin kemi 4.8 milion euro të realizuara presim që te kalojmë 5. milionshin ashtu siç ka qenë e paraparë edhe në buxhet për këtë vit. Sa i përket donacioneve këtë vit kemi fituar 1. milion euro ndersa në vitin 2021 e kemi përfundu projektin me të madh që është bërë ndonjeher në komunën e Pejës impianti i ujrave të zeza në Gorazhdevc ne vlerë 23. milion euro ku 3. milion janë te komunës se 9. milion bankës Gjermane, 8. milion të qeveris Zvicerane, 3 milion prej ministris së financave. Jemi kualifiku për grandin për menaxhim të mbeturinave është projekt që ka pas me fillu por për shkak rritjes çmimeve është shty po shpresoj që fillon dhe është projekt i madh me vler dikun 12 milion euro. Sa i përket buxhetit për investime kapitale janë 9 milion euro apo 78 % të shpenzuara sa i përket mallrave she shpenzimeve kemi arrit me shpenzu 4 milion euro apo 98 % te shepnzimeve komunale me i kry. Të kategoria e subvencioneve kan qenë 570. mij euro për ojq-të, klube sportive, shoqatav të ndryshme dhe ndërtimit të shtëpive për skamnor edhe këtu i kemi realizu të gjitha. Sfid për vitin 2022 ka qenë edhe ekzekutimi i vendimeve gjygesore nga ministria e financave për zbatimin e kontratës kolektive, kemi mbërri me përballu fal angazhimit të madh dhe kryrjes se gjysmës së obligimeve para dy viteve. Shumica e komunave të vogla janë në prag falimentitmi ose është dasht edhe investimet kapitale me jau marr përmbarus për me i kry obligimet e kontratës kolektive. Vitin tjetër do të jetë problem për be sepse vitin tjetër na binë obligimet e padive qe janë bërë për shujta dhe për kontraten e re që përfshin edhe rritjen e inflacionit. Problemi është se nëse meren këto prej kategoris së pagave dhe mëditjeve, atëher muajt e fundit do te jetë problem për komunën me i pagu pagat. Kjo është një permbledhje e një aktiviteit 1 vjeqar të punve që jon kry në pika të shkurta.

Kërkesat e qytetarëve:

Agim Haxhija- BL- Treboviq :

Drejtori i shendetësis – Mungon

Mamaografia në Qkmf nuk punon,

Analiza e fëmijeve në Qkmf procedura e gjatë,

Qyshk kanalizimi Gasht,

Qyshk depo e druvë ne shkoll.

PAVLAN:

Kanale të ujitjes,

Asfaltim i rrugëve ,

BLLAGAJ:

Ndriçimi publik,

Asfaltimi i rrugëve,

Kanale të ujitjes 850. metra.

TREBOVIQ:

Renovim i kulmit të shkollës ,

Kanali të hapet dhe të betonohet një pjese.

Gazmendi:

Projekti Borea ku është problemi i këti projekti vital për komunën e Pejës.

Mevlyde Idrizi :

Inspektoriati i arsimit me inspektu lincensimin e kurseve private të femijeve nepër shtëpi,

Pagesat e shujtave,

Qyshk- zgjerimi i rrugës 1. km,

Nivelizimi i cmimeve të bukës në vler prej 0.50 cent.

Sa kërkesa janë deponuar me shkrim nga anëtare e kuvendit për buxhetin e vitit 2023 dhe sa janë hy ne buxhet e sa jo dhe arsye pse.

Rozafa Hajdari:

Bursat për studentet,

Rruga e fshtit u dëmtu për shkak të kanalizimit,

Ndriçimi publik në rrugën “Adem Fejza”.

Nimon Aliu- Katun I ri:

Ndërtimi i trotuarit,

Rregullimi i ndriçimit publik,

Rregullimi i rrugës kryesore,

Saravija- nuk e kanë pengu qytetarët po se ka punu sipas planit.

Agim Nikqi- Bl Rrokaqelli:

Rregullimi i kulmit dhe mureve të ndërtesat në rrugën “Armend Kukleci”,
Trotuari përball stacionit,
Ndriçimi të shkolla” Ramiz Sadiku”,
Kanali “Seravija” me u rregullu,
Rregullimi i rrugës prej “ Deltas”.

Rabe Nikqi:

Fshati Reke e Allages rrugët për vitin 2023,
“Ura e Gurit” pjerina me intervenu për fëmij dhe persona me karroca.

Agron Nikqi- BL Rugov:

Mirëmbajta e rrugës Pejë-Bogë,

Kryetari Gazmend Muhaxheri: sa i përket mamografis punëtorja qe ka punu aty e ka lëshu punën tash jemi tu shiku me gjet mundësin me punësu dikën. Drejtori edhe pse mungon në takimi ai i kryen krejt punët që lidhen me drejtorat të shendetësis. Shkolla në Qyshk ka mbet pa u kry edhe pse u dasht me u u përfundu më shkollë ka pas problem me një pjesë aty edhe me qështje të pronës duhet me u zgjidh, kjo ndoshta edhe në kuvend me kalu . Rrugët pa u asfaltu kanë mbet sepse operatori nuk ka punu. Të shkolla “Skendërbeu” ka pas me u punu fasada po nuk ka punu operatori, po tash me këtë projektin e efqincient të energjisë ka me u punu fasada edhe ka me u bë një prej shkollave me të mira. Kanali i ujitjes besoj që vitin tjetër duhet me pa qysh kemi me mujt me e realizu. Të pytja e Gzmendit kemi diskutu për buxhet edhe me ministrin e financave, mirëpo është mbet veq buxheti që është miratu komunë të Pejës nuk ka nda diçka shtesë ju edhe gato 33. milion tonat na i keni prezantu të qytetarët. Puna e partneritetit publiko-privat; e ndëgjova ministrin kur diskutoj, por problemi qëndron te zonimi i parkut “Bjeshkët e Nemuna mirëpo edhe ministri i infrastruktures z.Aliu por edhe anëtari i kuvendit z. Ganiqi na kanë premtu që këtë vit kemi me dergu ligjin në parlament me u kry. Pjesa tjetër nëse ministria nuk vendos pengesa ligjore kjo ka me u kry shumë leht. Ky projekt nuk është politik por është qendra ma e

madhe që mundet me u kry në Kosovë dhe Shqipëri. Operatori ka kërku grancion sovran për projekt, po na i kemi tregu që ai garancion nuk ipet prej qeveris së Republikës së Kosovës. Te Mevlydja, kurset private po janë problem me i ndal sepse krejt janë të përfshim këtu, për shujta janë tu i marr me përmbarus. Për zgjerimin e rrugës duhet me hi në projekt kur bëhet buxheti më kerkes të përfaqesutit të bashkësis lokale, për çmim të bukës kemi pas atëher bahskëpunim me agjencionin e konkurencës edhe atëher ai është marrë me këto furra po tash është ma problem. Sa i përket kërkesave të anëtarëve të kuvendit këta e shpjegon Jetoni. Sa i përket bursave nuk kemi nda bursa por këtë vit e kemi plan me nda për studenta që janë ndër vitin e dytë matematik dhe fizikë si profesione deficitare në sektorin e arsimit, ndërsa pjesa tjetër e profesionev janë (suficit). Kanalizimi Radac - Jabllanicë e madhe është projekt i qeveris, vjet ka qene i pezullum sivjet ka fillua, së di me çfarë motivacioni? komuna s'ka të bëjë me to. ndriçimi publik nuk funksionon e kemi lanë me intervenu por nuk kemi pasë njaftueshëm buxhet. Sa i përket ndriçimit duhe të jëmi racional se i kemi 18. mijë trupa ndriçues e normal që disa nuk funksionojn sepse edhe nepër shtëpi tona nuk funksionojnë disa por duhet me mirkuptu. Trotuari i Katunit të Ri i vjen rendi ma von sepse ne jemi tu i bo njëherë në rrugët kryesore edhe afer shkollave. Të ndriçimi është fshat që e ka pas ndriçimin e vet çka mundem me rregullu rregullojm, rrugët janë me gropa është kompetenc e qeveris kjo kryesorja mirpo na deri ka prilli intervenojm. Sa i përket kulmit nga azbesti janë kancerogjene, kur isha në Franc komplet një pjes se kalova ndej ishin kulmat e tillë. Te pjeset tjera duhet me intervenu me i rregullu aty ku ka problem. Për Reke të Allages i kemi tenderu gati krejt rrugët për mu asfaltu nëse ka mbet ndonjë për 2024 e përfundojm , po ka me pas problem me i kry operatorit ende si kane kry obligimet e 2021 e kanë me pas problem me fillu me këto te rejat.

Z. Jeton Abazaj: te shujtat një sqarim deri me tani jan ekzektu dikun 10 shkolla varësisht qysh jon kry nga thesari jemi ne pritje edhe per tjert, prej disas shkollave varet prej thesarit deri 3 mujorshin e viti 2023 duhet me u kry.Sa i përket pytjes se dyt i vetmi që ka ba kërkes me shkrim është anëtari i kuvendit Nezir Jahmurataj nga Lista Guxo.

Berat Ganiqi:

Plani Hapësinor ka me kalu në qeveri nesër, për dallime nga qeverit e kalum që nuk e kanë bo,

Projekti “Borea” problem që ka me u bo sepse operatori që e ka fitu ka kapital vetëm 200 mijë euro ndërsa po kërkon garancion prej shteti në vler prej 54. milion euro, këtu është problemi. Sa i përket rrugës se Rugovës pritë qe vitin e ardhshem ka me u bo rregullimi i saj.

Kryetari : operatori që po thuhet se i ka 200. mijë euro ai deri me tani ka investu 1. milion euro në fazen përgatitore, kështu që mbeten me u kry punët e nivelit qendror pastaj vazhdohet me tutje.

Mëqense u diskutuan të gjitha qështjete e parashtruar Kryesusi e mbylli takimin në ora 17.20.


Procesmbajtësi:

Egzon Kastrati





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEÇ

Lista e nënshkrimeve














TAKIM PUBLIK ME QYTETARË

I.NUMËER: 060/01/124701

Pejë.27.12.2022

Nr	Emri	Mbiemeri	Gjinia	Nëneshkrimi
1	Lu Lirim	SHATA	M	
2	VALBONA	AVDIJAJ	F	
3	Djellza	Zdraci Stalid	F	
4	Kaltrina	Telova	F	
5	SHKURBINI	ARXHI	M	
6	Agnes Hikeqi	DRELAJ	M	
7	Edi Fehmiu	YBERI	M	
8	LUAN RANATA	PGJË	M	
9	BESIM THAQI	POJË	M	
10	AGIM HAXHIU	HAXHIJAJ	M	
11	SEFER	MADËRGJAN	M	
12	Xhevdet Ahmeti	LIPË	M	
13	JAKUP LAJÇ	MALLAJ	M	
14	REXHEP HASANI	PEJË	M	
15	RABE NIKÇI	PGJË	F	

16	FRANUR BEXHISOGAJ	BOGË	M	Handwritten signature
17	Labind Dezdari	Peje	M	Handwritten signature
18	BESIM BEKISHA	PEJË	M	Handwritten signature
19	Simon Nika	Skatundiri	M	Handwritten signature
20	Kadi Gjogj	PEJË	M	Handwritten signature
21	Juraj Muzi	Reni Alleges		Handwritten signature
22	SHPEHO SALIHAD	DARDANIA - I -	M	Handwritten signature
23	Ajani Nikçi	Krokajelli	M	Handwritten signature
24	Njomza Jupa	Pejë	F	Handwritten signature
25	Rozafa Hajdari	Radac - Pejë	F	Handwritten signature
26	PUKALLET BEKISHA	B.L. KRYSHEC	M	Handwritten signature
27	Nexhat Miroci	B.T. "XH. KADA"	M	Handwritten signature
28	BEJHAR KRASNICI	B.L. KARAGAO	M	Handwritten signature
29	GAZMENO BACA	KARABAG		Handwritten signature
30	Kadri Mavroj	B.L. FISHTAROLI	M	Handwritten signature
31	Fetoh Bedlyalli	PEJË	M	Handwritten signature
32	Drita Haxhijaj	Pejë	F	Handwritten signature
33	Chelkyde Fohin	Pejë	F	Handwritten signature
34	ARIANIT KRASNICA	PEJË	M	Handwritten signature
35	Aaron Nikçi	PEJË	M	Handwritten signature
36	Abas Gega	Pejë	M	Handwritten signature
37	Nita Penduni	Pejë	F	Handwritten signature
38	TANIR SNAZA	BARAN	M	Handwritten signature

39	APTA NAULBANI	PEJE	F	
40	NASRET HAJRISI	PEJE	M	
41	EDONETA BEKISHA	PEJE	F	
42	GËZIM GASHI	PEJE	M	
43	XHENET S. KEMENDI	PEJE	F	
44	JERON ABAZANI	PEJE	M	
45	Berit Ganiqi	PEJE	M	
46	Iliret Shogorri	PEJE	M	
47	Fatmir Asllani	PEJE	M	
48	Rexhep Kontosaj	PEJE	M	
49	GAZMEND MUHAMMEDI	PEJE	M	
50	AVNI GASHI	PEJE	M	
51	Egzon Kastrioti	PEJE	M	
52				
53				
54				
55				
56				
57				
58				
59				
60				
61				